



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 13 korrik 2010, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Radmila Vujoviq, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha dhe Mufera Šinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Valdete Daka – KQZ, Xhemajl Peçani – KQZ, Blerim Buriani – KQZ, Driton Selmanaj - NDI, Lumnije Murati - ZPRK, Sanije Berisha dhe Bujar Basha – OSBE, Dafina Bardhi dhe Albulena Ademi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të punës së KQZ - së për vitin 2009 me plotësimet e kërkuara nga Komisioni,
3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në P/L për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nr. 03/3671/L-214,
4. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore në P/L për Avokatin e Popullit dhe në P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit të punës së KQZ - së për vitin 2009 me plotësimet e kërkuara nga Komisioni

Kryetari - I njoftoi se raporti i KQZ - së është shqyrtuar në mbledhjen e 7 qershorit dhe është vlerësuar se në raportin e KQZ - së nuk janë përfshirë sfidat dhe vështirësitë që e kanë përcjellë punën e KQZ - së, prandaj është vendosur që t'i jepet afat për plotësimin e tij. Kërkoj nga përfaqësuesit e KQZ - së ta marrin fjalën duke paraqitur raportin plotësues duke ju shmangur përsëritjeve që janë diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Valdete Daka – Tha se me kërkesën e Komisionit u janë dërguar plotësimet e kërkuara, prandaj janë dhënë detaje lidhur me procesin zgjedhor dhe vështirësitë që ka pasur KQZ - ja. Për detaje të tjera do të flasë z. Blerim Buriani.

Blerim Buriani – Në fjalën e tij e quajti të drejtë kërkesën e Komisionit që të përfshihen në Raport sfidat që ka pasur KQZ - ja gjatë procesit zgjedhor. Ai tha se një nga problemet ka qenë çështja e listave votuese dhe procesi i decentralizimit, sepse për KQZ - në janë nevojitur kapacitete shtesë, e që ka qenë një përgjegjësi shtesë. Përmendi përudhen e kundërshtimit të procesit dhe konfirmimit të listës votuese që ky proces ka shkuar përmes sistemit gjyqësor. Në vazhdim ceku se votuesit, të cilët ndryshojnë qendrën e tyre të votimit, është bërë përpjekje që përmes informimit publik ata t'i orientojmë në qendrën e votimit, nëse e kanë ndërruar edhe vendbanimin. Problem tjetër që e ka përcjellë punën e KQZ - së ka qenë edhe votimi jashtë Kosovës, i cili ka qenë edhe mjaft i kushtueshëm në aspektin financiar. Sfidat më të mëdha ka qenë votimi me kusht dhe një nga rekomandimet tona ka qenë që të mendohet që në të ardhmen të hiqet kjo mënyrë e votimit, sepse sjell shumë pengesa, si dhe çështja e ankesave dhe parashtrësive. Ai dha detaje rreth procesit të ankesave dhe parashtrësive për të cilat janë dhënë detaje në raportin plotësues.

Kryetari - Duke folur rreth sqarimeve të dhëna nga përfaqësuesit e KQZ - së tha se duhet të rishikohet çështja e mos përfshirjes së votimit me kusht në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe të bëhet spastrimi i listave të votuesve në bashkëpunim me institucionin e autorizuar, ngase këto janë disa nga vështirësitë që i ka pasur KQZ - ja. Në vazhdim tha se duhet të shikohet edhe çështja e votimit jashtë vendit.

Gani Geci - Në fjalën e tij ngriti çështjen e listave votuese duke shtuar se në këto lista figurojnë persona të cilët janë të vdekur dhe për të cilët dikush ka votuar në emër të tyre, andaj në lidhje me këtë do të ishte mirë të bëhet spastrimi i listave. Ai në vazhdim përmendi çështjen e votimit jashtë Kosovës, e që në emër të tyre është votuar pa qenë ata në Kosovë. Ishte i mendimit që vendnumërimet duhet të monitorohet me kamera, nuk do të thosha që të jenë edhe vendvotimet, sepse do të ishte tepër e kushtueshme, por të monitorohen vendnumërimet. Ai shprehu mendimin se procesverbalet që vinë në vendin e numërimit dhe procesverbalet që mbetet në qendrën e votimit duhet të jenë të fotografuara në mënyrë digjitale nga KQZ - ja në mënyrë që atë të përputhen njëra me tjetrën.

Armend Zemaj - Në fjalën e tij tha se edhe në mbledhjen e kaluar kam pasur vlerësim pozitiv duke i pasur parasysh faktin se janë zgjedhjet e para të organizuara nga vendoret dhe sigurisht që kjo ka qenë një sfidë për ta dhe njëherit ka qenë edhe brengë e jona. Ai tha se ky plotësim ka qenë i nevojshëm, sepse do të na ndihmojnë edhe neve si ligjvënës që ta kemi më të qartë se çfarë procesi zgjedhor do ta dëshirojmë dhe si do të jetë mbarëvajtja e tyre. Duke folur për listat e votuesve tha se në vitin e ardhshëm do të jetë më lehtë për shkak të regjistrimit të popullsisë. Ngriti shqetësimin rreth votimit jashtë Kosovës, sepse shumica e këtyre qytetareve janë shtetas të Kosovës e që të gjithë nuk kanë hequr dorë nga shtetësia dhe kjo mund të llogaritet që një numër i tyre konsiderohet që nuk kanë dalë në zgjedhje. Pyeti se a ka pasur ndonjë strategji KQZ - ja për ato vende ku janë anuluar zgjedhjet?

Bajram Kosumi - Tha se është një realitet i krijuar se vota e qytetareve nuk është e sigurt dhe se kemi një numër kaq të madhe të ankesave që fatkeqësisht kanë ndodhur edhe nuk duhet të lejojmë kësó praktika. Në vazhdim tha se një pjesë të asaj që është kërkuar nga mbledhja e kaluar në këtë raport është plotësuar, por ajo çka do të kisha dashur nga KQZ - ja është që të merret nisma që të qartësohen problemet të cilat u diskutuan, e jo vetëm kur kërkojnë të tjerët të merren nisma të tilla. Ai tha se do të duhej të merrej nisma që të hapet debat nga KQZ - ja edhe me partitë politike lidhur me mënyrat e votimit sidomos numërimi i votave dhe çështje të tjera, sepse është përgjegjësi e KQZ - së. Në vazhdim ngriti çështjen e kostove të fushatave zgjedhore, sepse me ligj kjo përcaktohet, por në anën tjetër ne e dimë që zgjedhjet në Kosovë janë ndër më të shtrenjtat në Evropë, pyeti se a është diskutuar kjo çështje nga KQZ - ja në mënyrë që të vepohet në pajtim me ligjin që të pamundësohet blerja e votës?

Radmilla Vujoviq – E përshëndeti prezencën e përfaqësuesve nga KQZ - ja, duke folur për raportin tha se shihet se cila është strategjia, prandaj vetëm duhet të respektohen rregullat dhe ligji dhe KQZ - ja do të funksionojë si duhet.

Gani Geci - Në fjalën e tij të serishme tha se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka një evidencë të atyre që marrin pensionet dhe ata janë të detyruar që çdo 6 muaj të lajmërohen dhe kjo do të mund të ishte një mundësi që të fshihen nga lista personat të cilët janë të vdekur, sepse nuk figurojnë në këto lista si përfitues të pensioneve.

Selviqe Halimi - Duke u ndërlidhur me parafolësin rreth propozimit që të fshihen nga lista personat që nuk figurojnë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale tha se kjo bie ndesh me ligjin, sepse që të fshihet nga lista duhet të ekzistojë certifikata e vdekjes. Duke folur rreth votimit me kusht dhe votimit jashtë Kosovës tha se do të duhej të zgjidheshin në nivel të të gjitha subjekteve politike me një konsensus politik. Në vazhdim tha me rastin e hartimit të ligjit duhet t'i kushtohet vëmendje KZAP - it ngase për çdo përsëritje të zgjedhjeve do të duhej që qytetarët të informohen rreth fakteve për anulimin e tyre.

Adem Hajdaraj - Në fjalën e tij shprehu shqetësimin, sepse është shumë e paqartë që anëtarët e KQZ - së dhe të GZAP- it të jenë edhe përfaqësues të partive politike. Ishte i mendimit që në momentin e zgjedhjes, qofshin si anëtarë të KQZ - së ose të GZAP – it, ata duhet të heqin dorë nga partitë, nëse duan të jenë real që të mos kenë ndikime partiake. Prandaj do të duhej që me rastin e ndryshim – plotësimit të ligjit kjo çështje të parashihet me ligj.

Pas diskutimeve që u zhvilluan, pyetjeve të anëtarëve ju përgjigjën z. Blerim Buriani, Valdete Daka dhe Xhemajl Peçani.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009.
2. Të ngritën kapacitetet e KQZ - së për menaxhimin përkatës të procesit zgjedhor në vendin e votimit dhe të numërimit të votave.
3. Të rishikohet çështja e mos përfshirjes së votimit me kusht në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe të bëhet spastrimi i listave të votuesve në bashkëpunim me institucionin e autorizuar.

3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në P/L për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nr. 03/3671/L-214

Kryetari paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e Komisionit për Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në P/L për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe kërkoi deklarinë e anëtarëve nëse kanë ndonjë vërejtje.

Pasi që nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nr. 03/3671/L-214 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore në P/L për Avokatin e Popullit dhe në P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional

Kryetari - I njoftoi anëtarët se komisionet kryesore kanë shqyrtuar Propozimamendamentet e Komisionit Funkcional në P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe në P/L për Avokatin e Popullit dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje në pikëpamje të vlerësimeve nga aspekti i ndikimeve buxhetore, të Drejtave të Komuniteteve dhe nga aspekti se a është në përputhje me Acquis Communautaire. Lidhur me këtë kërkoj pëlqimin e anëtarëve që të procedohen më tutje.

Komisioni vendosi të procedojë për shqyrtim dhe miratim në një nga mbledhjet plenare të Kuvendit P/L për Avokatin e Popullit dhe P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale, me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional

5. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni